



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** Gjykatësi i procedurës paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 26 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publike

---

**Version i redaktuar publik i**

**Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 35(3), 39(3), 41, 53, 54, dhe 55 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 50, 53, 55, 86(6)(b), dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtrioi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, së bashku me materialin provues në mbështetje të pretendimeve faktike dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.<sup>2</sup>

2. Më 28 maj 2020, Prokurori i Specializuar bëri kërkesë, ndër të tjera, për: (i) lëshimin e fletarrestimeve për Hashim Thaçin (“z. Thaçi”), Kadri Veselin (“z. Veseli”), Rexhep Selimin (“z. Selimi”), dhe Jakup Krasniqin (“z. Krasniqi”) (bashkërisht, “të akuzuarit”) dhe urdhrat përkatës të transferimit.<sup>3</sup>

3. Më 23 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake, me kërkesë të Prokurorit të Specializuar,<sup>4</sup> autorizoi që informacioni i mëposhtëm nga aktakuza të bëhej publik, konkretisht: (i) identitetet e z. Thaçi dhe të z. Veseli si persona të akuzuar; dhe (ii) numri i akuzave, cilësimi ligjor dhe natyra e krimeve të pretenduara, numri i përafërt i viktimave të ditura, dhe lidhjet ose përkatësia etnike e tyre.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për lëshimin e fletarrestimeve dhe për urdhra në lidhje me to* (“Kërkesa”), 28 maj 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00008, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për autorizim për nxjerrje informacioni në lidhje me Aktakuzën*, 23 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00009, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim mbi kërkesën urgjente të Prokurorit të Specializuar Kërkesa*, 23 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 2 korrik 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 24 korrik 2020 të dorëzonte për protokollim, ndër të tjera, një aktakuzë të rishikuar.<sup>6</sup>
5. Më 24 korrik 2020, ZPS-ja parashtroi një aktakuzë të rishikuar për konfirmim ("Aktakuza e Rishikuar").<sup>7</sup>
6. Më 11 shtator 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 30 shtator 2020 të dorëzonte, ndër të tjera, informacion në lidhje me adresën aktuale apo të fundit të ditur të të akuzuarve ("Urdhri i 11 shtatorit 2020").<sup>8</sup>
7. Më 21 shtator 2020, Kryetarja lëshoi vendimin mbi kërkesën për caktimin e vendit të procedurës në Holandë ("shteti pritës").<sup>9</sup>
8. Më 30 shtator 2020, ZPS-ja dorëzoi informacionin e kërkuar në urdhrin e 11 shtatorit 2020.<sup>10</sup>
9. Më 12 tetor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 19 tetor 2020 të dorëzonte parashtrime plotësuese për dy aspekte të caktuara në lidhje me arrestimin e z. Thaçi.<sup>11</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores*, 2 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim*, 24 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00015, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar për parashtrime plotësuese*, 11 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00017, Kryetarja, *Vendim mbi kërkesën për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës* ("Vendim për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës"), 21 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00019, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime plotësuese në bazë të urdhrin KSC-BC-2020-06/F00015*, 30 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00020, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar për parashtrime plotësuese*, 12 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

10. Më 19 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e kërkuara më lart.<sup>12</sup> Në të njëjtën ditë, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi një urdhër në të cilin caktohej data e synuar për nxjerrjen e vendimit mbi Aktakuzën e Rishikuar.<sup>13</sup>

11. Më 21 tetor 2020, ZPS-ja dorëzoi për protokollim njoftimin për një komunikim që kishte marrë prej z. Ben Emerson ("z. Emerson"), mbrojtës i z. Veseli.<sup>14</sup> Në të njëjtën ditë, ZPS-ja dorëzoi informacione të mëtejshme në pajtim me urdhrin e 11 shtatorit 2020.<sup>15</sup>

12. Më 26 tetor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake konfirmoi Aktakuzën e Rishikuar.<sup>16</sup>

## II. PARASHTRIMET

13. ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të lëshojë fletarrestime për të akuzuarit si dhe urdhrat gjegjës për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës.<sup>17</sup> Në lidhje me këtë, ZPS-ja pohon se kushtet e nenit 41(6) të Ligjit janë përmbushur.<sup>18</sup> ZPS-ja pretendon se ekziston dyshim i bazuar se të akuzuarit kanë kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>19</sup> ZPS-ja pretendon gjithashtu se ka arsye të artikuleshme për të besuar se: (i) ekziston rreziku i arratisjes së të akuzuarve;<sup>20</sup> (ii) të akuzuarit do të pengojnë ecurinë e

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00022, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimet e Prokurorisë në bazë të Urdhrit KSC-BC-2020-06/F00020* ("Parashtrime plotësuese të ZPS-së"), 19 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00023, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së synuar për një vendim sipas nenit 39(2)*, 19 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-06, F00024, Prokurori i Specializuar, *Njoftim për një komunikim* ("Njoftimi"), 21 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>15</sup> KSC-BC-2020-06, F00025, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i dytë plotësues i KSC-BC-2020-06/F00019*, 21 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>17</sup> Kërkesa, para. 2, 60(a).

<sup>18</sup> Kërkesa, para. 28.

<sup>19</sup> Kërkesa, para. 29.

<sup>20</sup> Kërkesa, para. 30-33.

procedimit penal, ndër të tjera duke ndikuar tek dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit;<sup>21</sup> dhe (iii) mund të përsërisin veprën penale ose të kryejnë një krim që kanë kërcënuar se do ta kryejnë.<sup>22</sup>

14. ZPS-ja kërkon më tej që fletarrestimet t'i transmetohen ZPS-së dhe të zbatohen prej saj, në bashkëpunim me Administratoren.<sup>23</sup> Në kuadër të zbatimit të fletarrestimeve, ZPS-ja kërkon autorizim që t'i bëjë ato të ditura për aq sa është e nevojshme për këtë qëllim.<sup>24</sup>

15. Në lidhje me transferimin e të akuzuarve, ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të urdhërojë transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, në përputhje me rregullën 50(1)-(2) të Rregullores.<sup>25</sup>

16. Z. Emerson, ndër të tjera, parashtron se nëse aktakuza kundër z. Veseli konfirmohet, është e panevojshme që gjykatësi i procedurës paraprake të lëshojë urdhër për arrestimin e tij sepse: (i) z. Veseli zotohet se do të udhëtojë vullnetarisht për në Hagë, për t'iu dorëzuar Dhomave të Specializuara;<sup>26</sup> dhe (ii) nuk ka prova që përlligjin vlerësimin se ai do të arratiset, ose do të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve.<sup>27</sup> Ndër të tjera, ai pretendon se z. Veseli: (i) është figurë e njohur publike që jeton me familjen e tij në Prishtinë dhe mban një post politik publik, çka eliminon çdo rrezik të arratisjes;<sup>28</sup> dhe (ii) ka dijeni për ekzistencën e një aktakuze kundër tij që prej qershorit 2020 dhe, rrjedhimisht, konfirmimi i aktakuzës nuk mund ta ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme vlerësimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6).<sup>29</sup> Së fundi, z. Emerson parashtron se në mungesë të provave të drejtpërdrejta dhe të besueshme për implikimin e tij personal në ndërhyrje ndaj dëshmitarëve, nuk ka bazë që z. Veseli t'i

---

<sup>21</sup> Kërkesa, para. 30, 34-38.

<sup>22</sup> Kërkesa, para. 30, 39-40.

<sup>23</sup> Kërkesa, para. 56.

<sup>24</sup> Kërkesa, para. 58.

<sup>25</sup> Kërkesa, para. 41.

<sup>26</sup> Shtojca 1 e Njoftimit, f. 3.

<sup>27</sup> Shtojca 1 e Njoftimit, f. 3-4.

<sup>28</sup> Shtojca 1 e Njoftimit, f. 3.

<sup>29</sup> Shtojca 1 e Njoftimit, f. 3.

hiqet liria, dhe thekson që shqetësimet e mjegullta apo të përgjithshme lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë janë të pamjaftueshme për këtë qëllim.<sup>30</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

17. Në përputhje me nenin 39(3) të Ligjit dhe rregullën 86(6)(b) të Rregullores, me kërkesën e Prokurorit të Specializuar, gjykatësi i procedurës paraprake mund të lëshojë çfarëdo vendimi apo urdhri që mund të kërkohet për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

18. Në pajtim me nenin 41(6)(a) të Ligjit, përpara se të mund të lëshohet fletarrestim, ZPS-ja duhet të demonstrojë së pari se ekziston dyshim i bazuar që personi ka kryer veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Së dyti, ZPS-ja duhet të provojë se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston të paktën një prej tri arsyeve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, konkretisht se: (i) ekziston rreziku që personi të arratiset; (ii) personi do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e ndonjë veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procedurës penale duke ndikuar tek dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një veprë penale në tentativë, ose do të kryejë një krim që ka kërcënuar se do ta kryejë. Së fundi, në pajtim me nenin 41(1), (4), dhe (5) të Ligjit, lëshimi i fletarrestimit duhet të jetë në përputhje me të drejtat themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës dhe personi në fjalë duhet të informohet për të drejtat e veta sipas Ligjit, me qëllim që t'i ushtrojë ato të drejta para gjykatësit të procedurës paraprake.

19. Në pajtim me rregullën 53(2) të Rregullores, fletarrestimi përmban informacionin në vijim: (i) emrin dhe mbiemrin e personit dhe të dhëna të tjera identifikuese përkatëse; (ii) përmendje konkrete të krimeve për të cilat kërkohet arrestimi i personit; (iii) një përshkrim të shkurtër të fakteve që pretendohet se përbëjnë ato krime; dhe

---

<sup>30</sup> Shtojca 1 e Njoftimit, f. 3-4.

(iva) nëse është e zbatueshme, objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në të cilin personi do të transferohet. Rregulla 53(3) e Rregullores përcakton që fletarrestimi mbetet në fuqi deri në një urdhër tjetër të panelit.

20. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që i janë dhënë Policisë së Kosovës sipas ligjeve të Kosovës.

21. Pas lëshimit të fletarrestimit nga Dhomat e Specializuara, neni 55 i Ligjit dhe rregullat 50(2) dhe 208(1) të Rregullores përcaktojnë se gjykatësi i procedurës paraprake mund të kërkojë transferimin e personit në fjalë nga autoritetet kompetente të një shteti të tretë në Dhomat e Specializuara, në bazë të një marrëveshjeje midis atij shteti dhe Dhomave të Specializuara, një marrëveshjeje midis atij shteti dhe Kosovës, ose në bazë të reciprocitetit. Gjithashtu, rregulla 55(3) e Rregullores parasheh që kur fletarrestimi është në lidhje me një person vendndodhja e të cilit është ose dihet se ka qenë së fundi në një shtet të tretë që ende nuk ka marrë përsipër obligimin e dhënies së ndihmës, kërkesën për bashkëpunim së bashku me fletarrestimin, Administratori ua transmeton autoriteteve kompetente të atij shteti.

22. Në pajtim me rregullën 55(4) të Rregullores, pasi merr njoftim për arrestimin e kryer nga autoritetet kompetente, Administratori bën përgatitjet e nevojshme, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të shtetit pritës, për transferimin e menjëhershëm të personit të arrestuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

23. Në pajtim me nenin 41(7) të Ligjit, personat që janë objekt i fletarrestimit mund të paraburgosen në objektin e paraburgimit të mbikëqyrur nga Dhomat e Specializuara dhe të administruar nga Zyra Administrative afër selisë së Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, nëse procedurat barten atje.

#### IV. DISKUTIM

##### A. JURIDIKSIONI

24. ZPS-ja kërkon lëshimin e fletarrestimeve dhe të urdhrave të transferimit për të akuzuarit, që të gjithë shtetas të Kosovës, për krime të parapara në nenet 13(1) dhe 14(1)(c) të Ligjit, të kryera në Kosovë dhe në Shqipërinë Veriore prej më së paku marsit 1998 deri në shtator 1999.<sup>31</sup> Gjykatësi i procedurës paraprahe rikujton konstatimet e tij se janë përmbushur kushtet e kërkuara të juridiksionit lëndor, kohor dhe territorial në bazë të neneve 6-8 të Ligjit.<sup>32</sup>

##### B. BARRIERA PROCEDURALE NË LIDHJE ME Z. THAÇI

25. Përpara se të trajtohet themelësia e kërkesës së ZPS-së për lëshimin e fletarrestimit dhe të urdhrit të transferimit kundër z. Thaçi, gjykatësi i procedurës paraprahe vëren se i akuzuari është aktualisht President i Kosovës i cili, në parim, gëzon imunitete sipas Kushtetutës së Kosovës dhe së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, kjo barrierë procedurale nuk zbatohet në këtë procedim *sub judice*, për shkak të kornizës ligjore ekzistuese të Dhomave të Specializuara, përfshirë edhe Kushtetutën e Kosovës. Gjykatësi i procedurës paraprahe vë në dukje nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015, për rregullimin me ligj të organizimit, funksionimit dhe juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>33</sup> Neni 162(8) i Kushtetutës përcakton, në pjesën përkatëse se “çdo person i akuzuar për krime nga Dhomat e Specializuara mund të paraburgoset dhe të transferohet në Dhomat e Specializuara që ndodhen jashtë territorit të Kosovës” (theximi i shtuar). Rrjedhimisht, neni 162(8) i Kushtetutës së Kosovës lejon arrestimin, transferimin dhe,

---

<sup>31</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 16, 18, 57, 59, 95-96, 136-137, 172.

<sup>32</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 43.

<sup>33</sup> Lidhur me përputhshmërinë e nenit 162 me Kushtetutën e Kosovës, shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, [Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me shkresën nr. 05-433/DO-318](#), KO 26/15, 15 prill 2015.



në vijim, paraburgimin e çdo personi të akuzuar për krime në juridiksionin e Dhomave të Specializuara, përfshirë edhe Presidentin që mban postin aktualisht. Nga kjo rrjedh që imunitetet e z. Thaçi nuk përbëjnë barrierë procedurale për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrit të transferimit kundër tij.

## C. KUSHTET E NENIT 41(6) TË LIGJIT

### 1. Krimet që pretendohet se janë kryer

26. Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se, kur konfirmoi Aktakuzën e Rishikuar, ai konstatoi se ekziston dyshim i bazuar mirë që të akuzuarit kryen krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, konkretisht, krimet kundër njerëzimit të përndjekjes, burgimit, akteve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme, dhe zhdukjes me forcë, dhe krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, përkatësisht në shkelje të neneve 13(1) dhe 14(1)(c) të Ligjit.<sup>34</sup> Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se është përmbushur kushti i parë i nenit 41(6)(a) të Ligjit.

### 2. Domosdoshmëria e arrestimit

27. ZPS-ja parashtron se arrestimi i të akuzuarve është i domosdoshëm sepse ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekzistojnë që të tre rreziqet e parashikuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>35</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se konstatimi i ekzistencës së këtyre rreziqeve lidhet me vlerësimin e mundësisë së materializimit të këtyre rreziqeve kundrejt pashmangshmërisë së tyre.<sup>36</sup>

---

<sup>34</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 474, 478, 482, 491, 498, 505, 512.

<sup>35</sup> Kërkesa, para. 30; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 10, 16.

<sup>36</sup> Në mënyrë të ngjashme, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Dhoma e Apelit, [\*Judgment on the appeal of Mr Aimé Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aimé Kilolo Musamba'"\*](#), 11 korrik 2014, para. 107.

(a) Z. Thaçi

28. Në lidhje me rrezikun e arratisjes, gjykatësi i procedurës paraprake merr parasysh se z. Thaçi: (i) është në dijeni të vendimeve për fajësi penale të ish-anëtarëve drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe anëtarëve të identifikuar me emër të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët ("NKP"), të raportuara publikisht;<sup>37</sup> (ii) aktualisht është President i Kosovës dhe në të shkuarën ka qenë, ndër të tjera, Kryeministër i Kosovës dhe zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme,<sup>38</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh qeveritarë, ndër të cilët persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës;<sup>39</sup> (iii) ka qasje në fonde të konsiderueshme;<sup>40</sup> dhe (iv) ka mundësinë të udhëtojë lirisht në juridiksione që nuk kanë detyrimin ta transferojnë atë në Dhomat e Specializuara, ose për të udhëtuar tek të cilat nuk kërkohet vizë.<sup>41</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake vëren gjithashtu se z. Thaçi është në dijeni për ekzistencën e një aktakuze kundër tij që prej qershorit 2020 dhe se ai iu përgjigj fletëthirrjes dhe u paraqit për intervistë si i dyshuar me ZPS-në, më 13-16 korrik 2020. Megjithatë, ndonëse z. Thaçi mund të ketë qenë në dijeni të një farë informacioni të përgjithshëm për aktakuzën kundër tij, në atë kohë ende e pakonfirmuar, që në qershor 2020, dhe në vijim i është përgjigjur fletëthirrjes së ZPS-së, motivi i tij për t'u arratisur do të bëhet më i fortë pasi të informohet për akuzat e konfirmuara kundër tij dhe dënimet e mundshme, që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm.<sup>42</sup> Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se z. Thaçi ka motivin dhe mjetet për t'u arratisur.

---

<sup>37</sup> Kërkesa, para. 31.

<sup>38</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 3.

<sup>39</sup> Kërkesa, para. 4-5, 32; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 12.

<sup>40</sup> Kërkesa, para. 32; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 12.

<sup>41</sup> Kërkesa, para. 33; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 12.

<sup>42</sup> Kërkesa, para. 31; Vendimi i Konfirmimit, para. 521; Neni 44(1) i Ligjit.

29. Në lidhje me pengimin e procedimit përmes ndërhyrjes ndaj viktimave, dëshmitarëve, ose bashkëkryesve, gjykatësi i procedurës paraprake merr parasysh se z. Thaçi: (i) ishte anëtar themelues i UÇK-së, si edhe i Shtabit të Përgjithshëm të saj, ku mbajti poste me pushtet, ndër të tjera edhe atë të Kryekomandantit të UÇK-së,<sup>43</sup> dhe, si President i Kosovës, ai sot është në një post me pushtet dhe ndikim në Kosovë,<sup>44</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet shumë të gjerë përkrahësish për të penguar hetimet e ZPS-së dhe procedimin penal kundër tij;<sup>45</sup> (ii) ka sulmuar publikisht mandatin e Dhomave të Specializuara dhe është përpjekur t'i deligitmojë ato;<sup>46</sup> dhe (iii) bazuar në materialin e dorëzuar nga ZPS-ja, pretendohet se është orvatur të ndërhyjë në veprimtarinë hetimore të ZPS-së përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.<sup>47</sup> Në veçanti pretendohet se z. Thaçi, ndër të tjera, është përfshirë në pagesat që u ka bërë qeveria dëshmitarëve të mundshëm të ZPS-së<sup>48</sup> dhe [REDAKTUAR].<sup>49</sup> Për më tepër, gjykatësi i procedurës paraprake vëren se, ndonëse disa dëshmitarë dhe viktimë mund të pajtohen të zhvendosen me vendbanim, ZPS-ja ka bërë të ditur se jo të gjithë do të pajtohen me masa të tilla dhe se, sidomos në rrethanat e një gjykimi kundër ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së, masa të tjera mbrojtëse nuk do të trajtojnë plotësisht rreziqet e ndërhyrjes dhe frikësimit.<sup>50</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu thekson informacionin lidhur me atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që kanë dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën.<sup>51</sup> Në këto rrethana, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se z. Thaçi ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të ndërhyrë ndaj

---

<sup>43</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 2; Vendimi i Konfirmimit, para. 455.

<sup>44</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 3; Kërkesa, para. 34-35; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 12.

<sup>45</sup> Kërkesa, para. 35; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 13.

<sup>46</sup> Kërkesa, para. 7, 36; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 3-9 (Letër e Hashim Thaçit drejtuar Majkëll Pompeos, e raportuar në *Gazeta Express*).

<sup>47</sup> Kërkesa, para. 8, 10-17 dhe referencat e përfshira në të; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 3-4; Shtojca 3 e Kërkesës, f. 8; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 14.

<sup>48</sup> Kërkesa, para. 10-11 dhe referencat e përfshira në të.

<sup>49</sup> Kërkesa, para. 12; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 3-4.

<sup>50</sup> Kërkesa, para. 37.

<sup>51</sup> Kërkesa, para. 18-26, 34-35, 40; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 15.

dëshmitarëve, viktimave dhe bashkëkryesve dhe, për rrjedhojë, për të penguar ecurinë e procedimit penal.

30. Për sa i përket kryerjes së krimeve të mëtejshme, gjykatësi i procedurës paraprake merr parasysh se pretendohet që z. Thaçi mori pjesë në një NKP që vuri në shënjestër kundërshtarë realë ose të perceptuar të UÇK-së.<sup>52</sup> Duke mbajtur parasysh orvatjet e pretenduara të z. Thaçi për pengimin e procedimit<sup>53</sup> dhe atmosferën e përgjithshme të frikësimit që ka dëmtuar procedimin e anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën,<sup>54</sup> gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se ekziston rrezik i mëtejshëm se z. Thaçi mund të përdorë dhunën fizike ose kërcënime për dhunë fizike kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, ndër të cilët edhe viktima dhe dëshmitarë.

31. Bazuar në sa më sipër, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që z. Thaçi mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procedimit duke ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve, ose të kryejë krime të tjera, çka i bën të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij, në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit.

(b) Z. Veseli

32. Për sa i përket rrezikut të arratisjes, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh që z. Veseli: (i) është në dijeni të vendimeve për fajësi penale të ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së dhe të anëtarëve të identifikuar me emër të NKP-së, të raportuara publikisht;<sup>55</sup> (ii) aktualisht është udhëheqësi i Partisë Demokratike të Kosovës dhe në të shkuarën ka mbajtur poste të ndryshme, ndër të tjera atë të shefit të Shërbimit Informativ të Kosovës dhe të ministrit të Shërbimit Informativ në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës ("QPK"),<sup>56</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të

<sup>52</sup> Kërkesa, para. 40; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 14; Vendimi i Konfirmimit, para. 453, 474.

<sup>53</sup> *Shih më lart*, para. 29.

<sup>54</sup> Kërkesa, para. 18-26, 34-35, 40; Parashtrime plotësuese të ZPS-së, para. 15.

<sup>55</sup> Kërkesa, para. 31.

<sup>56</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 5-6.

gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh të qeverisë, ndër të cilët edhe persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës;<sup>57</sup> (iii) ka qasje në fonde të konsiderueshme,<sup>58</sup> dhe (iv) ka mundësinë të udhëtojë lirisht në juridiksione që nuk kanë detyrimin e transferimit të tij në Dhomat Specializuara, ose për ku nuk i nevojitet vizë.<sup>59</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake thekson gjithashtu se z. Veseli është në dijeni të ekzistencës së një aktakuze kundër tij që nga qershori 2020 dhe se është zotuar, ndër të tjera, që do të vijë vullnetarisht në Hagë dhe do t'u dorëzohet vetë Dhomave të Specializuara në rast të konfirmimit të aktakuzës kundër tij.<sup>60</sup> Megjithatë, edhe pse z. Veseli mund të ketë qenë në dijeni të një farë informacioni të përgjithshëm për aktakuzën kundër tij, në atë kohë ende e pakonfirmuar, që në qershor 2020, motivi i tij për t'u arratisur do të jetë edhe më i fortë kur të informohet për akuzat e konfirmuara kundër tij dhe dënimet e mundshme, që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm.<sup>61</sup> E njëjta vlen edhe për zotimin e z. Veseli për të ardhur vullnetarisht në Hagë, të bërë në një kohë kur ai nuk dinte se do të konfirmohej aktakuza kundër tij, dhe as për shkallën dhe natyrën e rëndë të akuzave të konfirmuara. Për më tepër, ky zotim duhet të vlerësohet në kontekstin e orvatjeve të pretenduara të z. Veseli për ndërhyrje në procedimet para Dhomave të Specializuara, çka sugjeron kundërshtim ndaj Dhomave të Specializuara.<sup>62</sup> Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se z. Veseli ka motivin dhe mjetet për t'u arratisur.

33. Për sa i përket pengimit të procedimit përmes ndërhyrjes ndaj viktimave, dëshmitarëve ose bashkëkryesve, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh se z. Veseli: (i) ishte një prej anëtarëve themelues të UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm të saj, ku mbajti poste me pushtet, ndër të tjera edhe atë të shefit të

---

<sup>57</sup> Kërkesa, para. 4-5, 32.

<sup>58</sup> Kërkesa, para. 32.

<sup>59</sup> Kërkesa, para. 33.

<sup>60</sup> Shtojca 1 e Njoftimit, f. 3.

<sup>61</sup> Kërkesa, para. 31; Vendimi i Konfirmimit, para. 521; Neni 44(1) i Ligjit.

<sup>62</sup> *Shih më poshtë*, para. 33.

shërbimit të zbulimit të UÇK-së,<sup>63</sup> dhe aktualisht është në post me pushtet dhe ndikim në Kosovë,<sup>64</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish për të penguar hetimet e ZPS-së dhe procedimin penal kundër tij;<sup>65</sup> dhe (ii) në bazë të materialit të dorëzuar nga ZPS-ja, pretendohet se është orvatur të ndërhyjë në punën hetimore të ZPS-së përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.<sup>66</sup> Konkretisht, pretendohet se z. Veseli, ndër të tjera, është përfshirë në pagesat që u ka bërë qeveria dëshmitarëve të mundshëm të ZPS-së<sup>67</sup> dhe [REDAKTUAR].<sup>68</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu thekson se, megjithëse disa dëshmitarë dhe viktimë mund të pajtohen të zhvendosen me vendbanim, ZPS-ja ka bërë të ditur se jo të gjithë prej tyre do të pajtohen me një masë të tillë dhe se, sidomos në rrethana të një gjykimi të anëtarëve të lartë të UÇK-së, masat e tjera mbrojtëse nuk do të mund të trajtojnë plotësisht rreziqet e ndërhyrjes dhe frikësimit.<sup>69</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake vë në dukje gjithashtu informacionin në lidhje me atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që kanë dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën.<sup>70</sup> Në këto rrethana, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se z. Veseli ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve dhe, rrjedhimisht, për të penguar ecurinë e procedimit penal.

34. Në lidhje me mundësinë e kryerjes së veprave penale të tjera, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh pretendimin se z. Veseli mori pjesë në një NKP që kishte në shënjestër kundërshtarë realë ose të perceptuar të UÇK-së.<sup>71</sup> Duke marrë parasysh orvatjet e pretenduara të z. Veseli për pengimin e procedimit<sup>72</sup> dhe atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që ka dëmtuar procedimin e

---

<sup>63</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 5.

<sup>64</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 6; Kërkesa, para. 34-35.

<sup>65</sup> Kërkesa, para. 35.

<sup>66</sup> Kërkesa, para. 8, 10-17 dhe poshtëshënimet e përfshira aty; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 3-4.

<sup>67</sup> Kërkesa, para. 10-11 dhe poshtëshënimet e përfshira aty.

<sup>68</sup> Kërkesa, para. 12; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 3-4.

<sup>69</sup> Kërkesa, para. 37.

<sup>70</sup> Kërkesa, para.18-26, 34-35, 40.

<sup>71</sup> Kërkesa, para. 40; Vendimi i Konfirmimit , para. 453, 474.

<sup>72</sup> *Shih më lart*, para. 33.

anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën,<sup>73</sup> gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston rrezik i mëtejshëm se z. Veseli mund të përdorë dhunë fizike ose kërcënime për përdorimin e dhunës fizike ndaj atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, ndër të cilët edhe viktimat dhe dëshmitarët.

35. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që z. Veseli mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procedimit përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit, apo të kryejë vepra penale të tjera, çka i bën të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit.

(c) Z. Selimi

36. Për sa i përket rrezikut të arratisjes, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh: (i) vënien në dijeni të z. Selimi për akuzat e paraqitura në aktakuzën që do t'i dorëzohet, si dhe për dënimet e mundshme, që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm;<sup>74</sup> (ii) dijeninë e tij për vendimet për fajësi penale të ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së dhe të anëtarëve të NKP-së, të raportuara publikisht;<sup>75</sup> (iii) aktualisht është deputet në Kuvendin e Kosovës dhe në të shkuarën ka qenë, ndër të tjera, oficer i lartë në Trupat Mbrojtëse të Kosovës,<sup>76</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh të qeverisë, ndër të cilët edhe persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës;<sup>77</sup> (iii) ka qasje në fonde të konsiderueshme;<sup>78</sup> dhe (iv) ka mundësinë të udhëtojë lirisht në juridiksione që nuk kanë detyrimin e transferimit të tij në Dhomat e Specializuara, ose për ku nuk i nevojitet vizë,<sup>79</sup> çka demonstroi se ai ka motivin dhe mjetet për t'u arratisur.

<sup>73</sup> Kërkesa, para.18-26, 34-35, 40.

<sup>74</sup> Kërkesa, para. 31; Vendimi i Konfirmimit, para. 521; Neni 44(1) i Ligjit.

<sup>75</sup> Kërkesa, para. 31.

<sup>76</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 9.

<sup>77</sup> Kërkesa, para. 4-5, 32.

<sup>78</sup> Kërkesa, para. 32.

<sup>79</sup> Kërkesa, para. 33.

37. Për sa i përket pengimit të procedimit përmes ndërhyrjes ndaj viktimave, dëshmitarëve ose bashkëkryesve, gjykatësi i procedurës paraprahe mban parasysh se z. Selimi: (i) ishte një prej anëtarëve themelues të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, mbajti poste me pushtet, ndër të tjera edhe atë të shefit të Drejtorisë Operative të UÇK-së dhe të ministrit të Rendit Publik /ministrit të Punëve të Brendshme të QPK-së,<sup>80</sup> dhe në vitin 2010 u zgjodh deputet në Kuvendin e Kosovës,<sup>81</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish për të penguar hetimet e ZPS-së dhe procedimin penal kundër tij;<sup>82</sup> (ii) është përfshirë prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës në një listë të personave të cilëve u është bllokuar pasuria për arsye se kanë kërcënuar përpjekjet ndërkombëtare për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor, ndër të tjera përmes përfshirjes së mundshme në pengimin e zbatimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që themeloi UNMIK-un;<sup>83</sup> (iii) sipas informacionit të [REDAKTUAR], ka ndërhyrë në një proces tjetër në lidhje me orvatjen për vrasje të [REDAKTUAR].<sup>84</sup> Gjykatësi i procedurës paraprahe thekson gjithashtu se, megjithëse disa dëshmitarë dhe viktimë mund të pajtohen të zhvendosen me vendbanim, ZPS-ja ka bërë të ditur se jo të gjithë prej tyre do të pajtohen me një masë të tillë dhe se, sidomos në rrethana të një gjykimi të anëtarëve të lartë të UÇK-së, masat e tjera mbrojtëse nuk do të mund të trajtojnë plotësisht rreziqet e ndërhyrjes dhe frikësimit.<sup>85</sup> Gjykatësi i procedurës paraprahe gjithashtu thekson informacionin lidhur me atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që kanë dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën.<sup>86</sup> Në këto rrethana, gjykatësi i procedurës paraprahe konstaton se z. Selimi ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të ndërhyrë

---

<sup>80</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 8; Vendimi i Konfirmimit, para. 460.

<sup>81</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 9; Kërkesa, para. 34-45.

<sup>82</sup> Kërkesa, para. 35.

<sup>83</sup> Shtetet e Bashkuara, Urdhër Ekzekutiv 13219 për bllokimin e pasurive të personave që kërcënojnë përpjekjet ndërkombëtare për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor, 26 qershor 2001, 66 F.R. 34777. *Shih gjithashtu*, Kërkesa, para. 9.

<sup>84</sup> Kërkesa, para. 9 dhe poshtëshënimet e përfshira aty.

<sup>85</sup> Kërkesa, para. 37.

<sup>86</sup> Kërkesa, para. 18-26, 34-35, 40.



ndaj dëshmitarëve, viktimave dhe bashkëkryesve dhe, rrjedhimisht, për të penguar ecurinë e procedimit penal.

38. Në lidhje me mundësinë e kryerjes së veprave të tjera penale, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh pretendimin se z. Selimi mori pjesë në një NKP që kishte në shënjestër kundërshtarë realë ose të perceptuar të UÇK-së.<sup>87</sup> Duke marrë parasysh orvatjet e pretenduara të z. Selimi për të penguar procedimin<sup>88</sup> dhe atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që ka dëmtuar procedimin e anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën,<sup>89</sup> gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston rrezik i mëtejshëm se z. Selimi mund të përdorë dhunë fizike ose kërcënime për përdorimin e dhunës fizike ndaj atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, ndër të cilët edhe viktima dhe dëshmitarë.

39. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që z. Selimi mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procedimit përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët ose viktimat, apo të kryejë vepra penale të tjera, çka i bën të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit.

(d) Z. Krasniqi

40. Për sa i përket rrezikut të arratisjes, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh: (i) vënien në dijeni të z. Krasniqi për akuzat e paraqitura në aktakuzën që do t'i dorëzohet, si dhe për dënimet e mundshme, që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm;<sup>90</sup> (ii) dijeninë e tij për vendimet për fajësi penale të ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së dhe të anëtarëve të NKP-së, të raportuara publikisht;<sup>91</sup> (iii) në të shkuarën ka mbajtur disa poste, ndër të tjera atë të Kryetarit të Kuvendit të

---

<sup>87</sup> Kërkesa, para. 40; Vendimi i Konfirmimit, para. 453, 474.

<sup>88</sup> *Shih më lart*, para. 34.

<sup>89</sup> Kërkesa, para. 18-26, 34-35, 40.

<sup>90</sup> Kërkesa, para. 31; Vendimi i Konfirmimit, para. 521; Neni 44(1) i Ligjit.

<sup>91</sup> Kërkesa, para. 31.

Kosovës dhe ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës,<sup>92</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh të qeverisë, ndër të cilët edhe persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës;<sup>93</sup> (iv) ka qasje në fonde të konsiderueshme;<sup>94</sup> dhe (v) mund të udhëtojë lirisht në juridiksione që nuk kanë detyrimin e transferimit të tij në Dhomat e Specializuara dhe/ose për ku nuk i nevojitet vizë,<sup>95</sup> çka demonstroi se ai ka motivin dhe mjetet për t'u arratisur.

41. Për sa i përket pengimit të procedurave përmes ndërhyrjes ndaj viktimave, dëshmitarëve ose bashkëkryesve, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh faktin që z. Krasniqi: (i) ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe i Drejtorisë Politike të UÇK-së, mbajti disa pozita me pushtet, ndër të tjera atë të zëvendëskomandantit të UÇK-së, zëdhënësit të UÇK-së dhe QPK-së, dhe kryesit të detyrës së Presidentit të Kosovës,<sup>96</sup> çka i mundëson të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish për të penguar hetimet e ZPS-së dhe procedimin penal kundër tij;<sup>97</sup> dhe (ii) ka sulmuar publikisht ligjshmërinë dhe mandatin e Dhomave të Specializuara,<sup>98</sup> duke deklaruar, për shembull, se: "Amendamenti kushtetues për themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar kërkon suspendimin e dispozitave kushtetuese lidhur me sovranitetin e pushtetit gjyqësor. [...] Ju nuk keni as të drejtë kushtetuese juridike e as legjitimitet demokratik që të dorëzoni sovranitetin i cili në Republikën tonë buron nga populli si e drejtë e patjetërsueshme. [...] Ju, katër udhëheqësit institucionalë të Republikës së Kosovës nuk e keni as të drejtën as mandatin e as autorizimin të suprimoni sovranitetin e vendit.",<sup>99</sup> dhe se "[D]eputetët e Kuvendit të Kosovës që votuan për Ligjin për Dhomat

<sup>92</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 12.

<sup>93</sup> Kërkesa, para. 4-5, 32.

<sup>94</sup> Kërkesa, para. 32.

<sup>95</sup> Kërkesa, para. 33.

<sup>96</sup> Aktakuza e Rishikuar, para. 11-12; Kërkesa, para. 34-35; Vendimet e Konfirmimit, para. 468.

<sup>97</sup> Kërkesa, para. 35.

<sup>98</sup> Kërkesa, para. 7; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 11-23 (Reagim i Jakup Krasniqit në *Facebook*).

<sup>99</sup> Shtojca 2 e Kërkesës, f. 11-12 (Reagim i Jakup Krasniqit në *Facebook* i datës 3 qershor 2015).

e Specializuara kryen një shërbim të keq".<sup>100</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu thekson se, megjithëse disa dëshmitarë dhe viktimat mund të pajtohen të zhvendosen me vendbanim, ZPS-ja ka bërë të ditur se jo të gjithë prej tyre do të pajtohen me një masë të tillë dhe se, sidomos në rrethana të një gjykimi të anëtarëve të lartë të UÇK-së, masat e tjera mbrojtëse nuk do të mund të trajtojnë plotësisht rreziqet e ndërhyrjes dhe frikësimit.<sup>101</sup> Gjykatësi i procedurës paraprake thekson gjithashtu informacionin në lidhje me atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve që kanë dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën.<sup>102</sup> Në këto rrethana, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se z. Krasniqi ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, viktimave dhe bashkëkryesve dhe, rrjedhimisht, për të penguar ecurinë e procedimit penal.

42. Në lidhje me mundësinë e kryerjes së veprave të tjera penale, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh pretendimin se z. Krasniqi mori pjesë në një NKP që kishte në shënjestër kundërshtarë realë ose të perceptuar të UÇK-së.<sup>103</sup> Duke marrë parasysh kundërshtimin e shprehur të z. Krasniqi ndaj Dhomave të Specializuara<sup>104</sup> dhe atmosferën e përgjithshme të frikësimit që ka dëmtuar procedimin e anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën,<sup>105</sup> gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston rrezik i mëtejshëm se z. Krasniqi mund të përdorë dhunë fizike ose kërcënime për përdorimin e dhunës fizike ndaj atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, ndër të cilët edhe viktimat dhe dëshmitarët.

43. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që z. Krasniqi mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procedimit përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit, apo të kryejë vepra penale të tjera, çka i bën

<sup>100</sup> Shtojca 2 e Kërkesës, f. 20 (Reagim i Jakup Krasniqit në *Facebook* i datës 15 nëntor 2019).

<sup>101</sup> Kërkesa, para. 37.

<sup>102</sup> Kërkesa, para. 18-26, 34-35, 40.

<sup>103</sup> Kërkesa, para. 40; Vendimi i Konfirmimit, para. 453, 474.

<sup>104</sup> *Shih më lart*, para. 41.

<sup>105</sup> Kërkesa, para. 18-26, 34-35, 40.

të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit.

#### D. PËRPUTHSHMËRIA ME TË DREJTAT THEMELORE

44. ZPS-ja parashtron se gjatë zbatimit të fletarrestimeve do të merren masat e duhura për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve dhe të të drejtave themelore të të akuzuarve.<sup>106</sup> Duke mbajtur parasysh zotimin e ZPS-së për marrjen e masave të tilla, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se asgjë në kërkesën e ZPS-së për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave për transferim nuk është *prima facie* në mospërputhje me të drejtat themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Për këtë arsye, në pajtim me nenin 41(4) dhe (5) të Ligjit dhe rregullën 55(6) të Rregullores çdonjëri prej të akuzuarve informohet për të gjitha të drejtat që gëzon në bazë të Ligjit posa të paraburgoset dhe ndodhet nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, në mënyrë që t'i ushtrojë ato të drejta para gjykatësit të procedurës paraprake sa më shpejtë që të jetë e realizueshme.

#### E. URDHËR PËR TRANSFERIM NË OBJEKTIN E PARABURGIMIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

45. Për arsye të sigurisë dhe të administrimit të duhur të drejtësisë, ZPS-ja ka kërkuar caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës, në përputhje me nenin 3(8)(a) të Ligjit.<sup>107</sup> Duke marrë parasysh këtë ndryshim të vendit të zhvillimit të procesit,<sup>108</sup> gjykatësi i procedurës paraprake e gjykon të domosdoshme që të akuzuarit të transferohen në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, të administruar nga Administratorja, në shtetin pritës. Në përputhje me nenin 41(7) të Ligjit dhe rregullën 55(4) të Rregullores, Administratorja zbaton urdhrat për

<sup>106</sup> Kërkesa, para. 57.

<sup>107</sup> Parashtrimi i Parë, para. 4.

<sup>108</sup> Vendim për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës, f. 3.

transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës dhe bën përgatitjet e nevojshme praktike për transferimin pa vonesë të të akuzuarve.

#### F. ZBATIMI DHE DORËZIMI I URDRHAVE

46. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka Policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, ZPS-ja mund të konsiderohet “autoritet kompetent” brenda kuptimit të rregullës 49(1) të Rregullores, e aftë për zbatimin dhe dorëzimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat edhe fletarrestimet që i bashkëlidhen këtij vendimi.<sup>109</sup> Në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores, në bashkëpunim me ZPS-në, Administratorja transmeton urdhrat për transferim që i bashkëlidhen këtij vendimi. ZPS-ja mund t’i bëjë të njohura fletarrestimet nëse është e përshtatshme dhe e nevojshme për zbatimin e tyre.

47. Në rast se ZPS-ja informohet për ndonjë udhëtim të planifikuar ose aktual të të akuzuarve, apo se të akuzuarit ndodhen në territorin e një shteti të tretë, këtë informacion ia përcjell Administratores pa vonesë. Në qoftë se Administratorja merr një informacion të tillë nga ndonjë burim tjetër që nuk është ZPS-ja, këtë informacion ia përcjell ZPS-së pa vonesë. Administratorja në vijim dhe pasi të jetë këshilluar me Prokurorin e Specializuar ua përcjell fletarrestimin/fletarrestimet dhe urdhrin/urdhrrat për transferim që i bashkëlidhen këtij vendimi autoriteteve kompetente të shtetit të tretë përkatës, në përputhje me nenin 55 të Ligjit.

48. Pas mbërritjes nga Kosova në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe gjithsesi para paraqitjes së parë të tyre, Administratorja i paraqet gjykatësit të procedurës paraprake një raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e të akuzuarve, ku përfshihen të dhënat dhe informacioni përkatës i marrë nga ZPS-ja.

---

<sup>109</sup> Me informimin e Prokurorit të Specializuar për këtë vendim dhe tetë shtojcat e tij nëpërmjet sistemit elektronik *Legal Workflow*, transmetimi i dokumenteve përkatëse Prokurorit të Specializuar konsiderohet i kryer, në përputhje me rregullat 49(1) dhe 55(1) të Rregullores.

Në rast se arrestimi i të akuzuarve kryhet në territorin e një shteti të tretë, Administratorja përgatit dhe paraqet raport lidhur me çfarëdo veprimi që ka të bëjë me atë shtet, ose çfarëdo informacioni të mëtejshëm që mund të merret nga ai shtet, duke përfshirë (i) informacion në lidhje me bazën mbi të cilën ai shtet i tretë ka bërë marrëveshje ose mund të ketë marrë përsipër obligimin e dhënies së ndihmës Dhomave të Specializuara; dhe (ii) të dhëna dhe informacion relevant të marrë nga autoritetet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose ZPS-ja.

## V. VENDIM

49. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesën për lëshimin e fletarrestimeve (shtojcat 1, 3, 5, dhe 7);
- b. **MIRATON** kërkesën për lëshimin e urdhrave për transferim (shtojcat 2, 4, 6, dhe 8);
- c. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë dhe zbatojë fletarrestimet e bashkëlidhura në Kosovë;
- d. **URDHËRON** Administratoren që në këshillim me ZPS-në, fletarrestimin/fletarrestimet dhe urdhrin/urdhrat për transferim që i bashkëlidhen këtij vendimi t'ua transmetojë autoriteteve kompetente të cilitdo shteti të tretë, sipas rastit, për dorëzim dhe zbatim;
- e. **URDHËRON** ZPS-në të këshillohet me Administratoren lidhur me përgatitjet e nevojshme praktike për zbatimin dhe dorëzimin e fletarrestimeve që i bashkëlidhen këtij vendimi, përfshirë bërjen të njohur të tyre nëse është e përshtatshme dhe e nevojshme për zbatimin dhe dorëzimin e tyre;

- f. **URDHËRON** Administratoren të kryejë transferimin e të akuzuarve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Holandë; dhe
- g. **URDHËRON** Administratoren që pas mbërritjes së të akuzuarve në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe gjithsesi para paraqitjes së parë të tyre, të paraqesë raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e të akuzuarve, sikurse përcaktohet më me hollësi në paragrafin 48.

/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i procedurës paraprake**

E hënë, 26 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.